



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth & Sports

Nr. 24/2015
Datë: 19.02.2015

Ministri i Kulturës Rinisë dhe Sportit z. Kujtim Shala, në mbështetje të nenit 145 (pika 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4,21 dhe 22 të Ligjit Nr. 03/L-189, për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2012), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe Shtojcën 7(shtatë) të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011), mori këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Këshilli Drejtues i Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës.
2. Këshilli Drejtues i Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës ka këtë përbërje:
 - 2.1. Edi Shukriu, historiane - arkeologe
 - 2.2. Premtim Alaj, arkeolog
 - 2.3. Florina Jerliu, arkitekte
 - 2.4. Ismajl Hasani, sociolog
 - 2.5. Valon Shkodra, përfaqësues i MKRS-së.
3. Këshilli Drejtues i Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës emërohet me mandat 4 (katër) vjeçar dhe është përgjegjës të ushtrijë të gjitha kompetencat e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
4. Anëtarët e Këshillit Drejtues kompensohen financiarisht për punën e tyre.
5. Kompensimi lejohet në vlerë prej 125.00 (njëqind e njëzet e pesë) euro për kryetarin e Këshillit Drejtues, ndërsa 100.00 (njëqind) euro për anëtarët e Këshillit Drejtues për secilën mbledhje.
6. Kompensimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues lejohet më së shumti për dy mbledhje të mbajtura gjatë muajit.

7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kujtim Shala,
Ministër

Vendimi iu dërgohet:

- Kabineti të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Palëve;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së.

